	<b>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit</b>	<b>DT-MO-010</b>
	<i>ver. 2</i>	<i>faqe 1 nga 6</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

**Operatori i Sistemit  
të Transmisionit dhe Tregut  
të Kosovës**

**(KOSTT)**


**Metodologjia për  
Llogaritjen e Çmimit të Jobalancit**

**Prill 2024**



**PËRMBAJTJA**

<b>1. OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI.....</b>	<b>3</b>
<b>2. KOHA E APLIKIMIT TË METODOLOGJISË.....</b>	<b>3</b>
<b>3. PËRGJEGJËSITË E PALËVE .....</b>	<b>3</b>
<b>4. DEFINICIONET.....</b>	<b>4</b>
<b>5. NDRYSHORET .....</b>	<b>4</b>
<b>6. METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TË JOBALANCIT.....</b>	<b>5</b>
<b>7. TË DHËNAT E APROVUARA NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI .....</b>	<b>5</b>
<b>8. SHTOJCA 1.....</b>	<b>5</b>

	<b>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit</b>	<b>DT-MO-010</b>
	<i>ver. 2</i>	<i>faqe 3 nga 6</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

## 1. Objektivat dhe fushëveprimi


- 1.1. Duke pasur parasysh mungesën e resurseve për balancim të sistemit të energjisë elektrike në Kosovë si dhe përmirësimin e performancës sa i përket balancimit të sistemit është e nevojshme që të përpilohet një metodologji për llogaritjen e çmimit të jobalancave për palët tregtare në Kosovë.
- 1.2. Metodologjia referohet në nenin 1.8 të Rregullave të Tregut në lidhje me pamjaftueshmërinë e zhvillimit të konkurrencës me çmime të arsyeshme të tregut, dhe mundësinë e aplikimit të çmimeve të rregulluara për jobalancë.

## 2. Koha e aplikimit të metodologjisë

- 2.1. Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritjes së çmimit të jobalancit të energjisë të palëve në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për periudhën me kushte të mungesës së një tregu konkurrues.
- 2.2. Në kushtet e tregut konkurrues kjo procedurë nuk aplikohet.
- 2.3. Për ndërprerjen e aplikimit të kësaj metodologjie palët do të njoftohen nga ZRrE dy muaj më herët.

## 3. Përgjegjësitë e Palëve

- 3.1. Operatori i Tregut është përgjegjës të:
  - 3.1.1. Zbatojë këtë metodologji, përmirësojë dhe azhurnojë varësisht nga ndryshimet në legjislacionin primar dhe sekondar në Kosovë si dhe implementimit më efektiv.
  - 3.1.2. Publikojë dhe vejë në dispozicion këtë metodologji për të gjitha Palët.
  - 3.1.3. Llogaritë jobalancet e palëve për çdo periudhë të barazimit përfundimtar dhe obligimet që palët kanë për jobalancet e shkaktuara.
  - 3.1.4. Lëshojë faturat palëve në baza mujore për obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara në harmoni me nenin 18 të Rregullave të Tregut.
- 3.2. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës të:
  - 3.2.1. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat matëse meritore për llogaritje të çmimit të jobalancit.
  - 3.2.2. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat e programit të nominimit.
  - 3.2.3. Jep instruksione ofruesve të shërbimeve balancuese për të blerë apo shitur energji për qëllim të balancimit të sistemit.
  - 3.2.4. I vë në dispozicion Operatorit të Tregut të gjitha informatat sipas paragrafit 6.1.
- 3.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës të:
  - 3.3.1. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat matëse të konsumatorëve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes të nevojshme për llogaritje të jobalancit të energjisë dhe çmimit të jobalancit.

	<b>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit</b>	<b>DT-MO-010</b>
	<i>ver. 2</i>	<i>faqe 4 nga 6</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

3.4. Prodhuesit janë përgjegjës të:

3.4.1. Vejnë në dispozicion për TSO apo DSO të gjitha të dhënat matëse relevante për llogaritjen e jobalancit dhe çmimit të jobalancit.

3.4.2. Paguajnë në baza mujore obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara në harmoni me nenin 18 të Rregullave të Tregut.

3.5. Furnizuesit janë përgjegjës të:

3.5.1. Paguajnë në baza mujore obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara në harmoni me nenin 18 të Rregullave të Tregut.


#### 4. Definicionet

4.1. Termet e definuar në këtë metodologji do të kenë kuptimet si në tabelën vijuese:

Termi i definuar	Interpretimi
Çmimi i jobalancit	Çmimi i llogaritur sipas pikës 6.3, 6.4 dhe 6.5 të kësaj metodologjie
<i>Koeficienti për shtyrje të energjisë</i>	<i>Koeficienti që shumëzohet me çmimin e simuluar të tregut kur jobalanci i sistemit është negativ ("sistemi shtynë në sistemet tjera")</i>
<i>Koeficienti për tërheqje të energjisë</i>	<i>Koeficienti që shumëzohet me çmimin e simuluar të tregut kur jobalanci i sistemit është pozitiv ("sistemi tërheq nga sistemet e tjera")</i>

#### 5. Ndryshoret

Ndryshorja	Përshkrimi
$\zeta_{bursës}$	Çmimi i bursës që është vlera maksimale ndërmjet çmimit të publikuar nga bursa hungareze e tregut një ditë para dhe çmimit të publikuar për Zonën Ofertuese të Kosovës nga bursa ALPEX për periudhën e barazimit përfundimtar $j$
$\zeta_{JB_j}$	Çmimi i jobalancit për periudhën e barazimit përfundimtar $j$
$K_{shtyrje}$	Koeficienti i aplikueshëm kur jobalanci i sistemit është negativ
$K_{tërheqje}$	Koeficienti i aplikueshëm kur jobalanci i sistemit është pozitiv

	<b>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit</b>	<b>DT-MO-010</b>
	<i>ver. 2</i>	<i>faqe 5 nga 6</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

## 6. Metodologjia e llogaritjes së çmimit të jobalancit

### 6.1. Parametrat hyrës të metodologjisë

#### 6.1.1. Koeficientët që shumëzohen me çmimin e Bursës për llogaritjen e çmimit të jobalancit

- Koeficienti për shtyrje të energjisë në sistem
- Koeficienti për tërheqje të energjisë nga sistemi

#### 6.1.2. Jobalanci i sistemit.

#### 6.1.3. Çmimi i bursës

### 6.2. Të dhënat dalëse të metodologjisë.

#### 6.2.1. Çmimi i jobalancave për çdo periudë të barazimit përfundimtar.

### 6.3. Kur jobalanci i sistemit është pozitiv (sistemi tërheq/ka mungesë) çmimi i jobalancit llogaritet ashtu që:

$$\zeta JB_j = \zeta_{bursës\ j} \times K_{\text{tërheqje}}$$

### 6.4. Kur jobalanci i sistemit është negativ (sistemi shtynë/ka tepriçë) atëherë çmimi i jobalancit përcaktohet ashtu që:

$$\zeta JB_j = \zeta_{bursës\ j} \times K_{\text{shtyrje}}$$

### 6.5. Kur sistemi është në balancë atëherë çmimi i jobalancit përcaktohet si: mesatare e çmimit të jobalancit të 720 orëve paraprake.

## 7. Të dhënat e aprovuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)

### 7.1. Të dhënat e aprovuara nga ZRRë do të jenë:


#### 7.1.1. Koeficienti për shtyrje.

#### 7.1.2. Koeficienti për tërheqje.

### 7.2. Vlerat e aprovuara sipas pikës 7.1 të këtij dokumenti janë dhënë në Shtojcën 1 e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse e kësaj metodologjie.

## 8. Shtojca 1

Koeficienti për shtyrje dhe koeficienti për tërheqje propozohen nga Operatori i Tregut dhe miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji çdo tre muaj nëse vlerësohet e nevojshme.

	<b>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit</b>	<b>DT-MO-010</b>
	<i>ver. 2</i>	<i>faqe 6 nga 6</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

<b>Përshkrimi</b>	<b>Shkurtesa</b>	<b>Njësia</b>
Koeficienti për shtyrje të energjisë	$K_{shtyrje}$	0.5
Koeficienti për tërheqje të energjisë	$K_{terheqje}$	1.5

(Fundi i dokumentit)